

2 Sistemi informativ i aleancës së ndërtimtarisë Zgjerim i sukseshëm i sistemit të kontrollit

3 Përbërja e parlamentit të ri në Zvicër Më i gjelbër, më femëror dhe më i majtë

4 Fuqizohet Lëvizja punëtore në Shqipëri Themelohet sindikata e re e minatorëve të bashkuar të Bulqizës

Nr. 7 | dhjetor 2019 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Marrëveshjet për qëndrim të përhershëm me disa vende Nga leja e qëndrimit L në atë C



Dy punëtorët migrantë të ndërtimtarisë në Zvicër: Adão Costa dhe kolegu e bashkëkombasi i tij Dinis. © Matthias Luggen

Portugezi Adão Costa nga viti 2005 kishte një leje të shkurtër qëndrimi L. Me 2018 atij i është thënë se do të kishte të drejtë në lejen e përhershme të qëndrimit C. Ai shtroi kërkesën gjegjëse dhe pas dy vitesh morri lejen C. Pas 14 vitesh në Zvicër, Costa më në fund arriti një siguri të caktuar qëndrimi.

Marília Mendes

Punëtori i ndërtimtarisë Adão Costa (57 vjeçar) nuk donte ti besonte sekretarës sindikaliste: Që ai kishte të drejtë në lejen C. Bile ai nuk kishte të drejtë as në lejen vjetore të qëndrimit B, pasi ai posedonte kontrata pune deri në 365 ditë. Si do të kishte atëherë të drejtë në lejen C? Sekretarja sindikaliste i shpjegoi atij, se kjo është e mundur në bazë të marrëveshjes për qëndrim të përhershëm mes Zvicrës dhe Portugalisë. Ai i plotësonte kushtet: Së paku 5 vite me qëndrim të rregullt e të pandërprerë në Zvicër. Mirëpo ai do të duhej të shtronte kërkesë për të realizuar këtë të drejtë. Ai nuk besonte tërësisht, megjithatë shtroi kërkesën. Çka do të mund të humbiste?

Proces i gjatë

Procesi zgjati dy vite dhe nga koha në kohë Costa humbte besimin në këtë mundësi. Deri në momentin kur ai e pa lejen C me emrin e tij! Çka ndjeu ai në atë moment? «Isha i lumtur. Mu hoq pesha. Kisha ndjenjën e trajtimit të barabartë. Unë njoh edhe kolegë tjerë në Zvicër, të cilët janë një kohë më të shkurtër se unë këtu dhe që së

shpejti do të marrin lejen B dhe pastaj edhe atë C. Përse në këtu, në këtë Kanton, jo?»

Jeta me një leje L

Jeta me një leje të shkurtër qëndrimi L domethënë, bërja dhe pagesa e disa kartave identiteti në vit, pamundësi qasjes për kredi, në rast papunësie shpesh kohë të gjata pritjeje për kompensim mëditjesh. Domethënë se tatimi dhe sigurimet janë më të shtrenjta, bile edhe tabelat e automjetit janë të përkohshme dhe duhet të përtërihen disa herë në vit. Pastaj shfaqet gjithmonë ndjenja e pasigurisë së qëndrimit. Me një leje C të qëndrimit, kolegu im Dinis thotë se mund të organizohet jeta për 5 vite, ndërsa me lejen L thua se nga muaji në muaj.

Jeta në Zvicër është e vështirë

Jeta këtu është e vështirë, thonë të dy punëtorët e ndërtimtarisë. Gjatë punës kryejnë punë të ndryshme. «Nga puna me lopatë dhe kazmë deri tek ndritja e mureve e betonimi, bëjë çka është e nevojshme.» Puna është e vështirë.

Kur në borë e shi duhet të punohet i lagur deri në kocka, atëherë bëhet tejet e vështirë. Mirëpo më e vështira është të jesh i vetmuar. Gruaja dhe fëmijët e Costas janë në Portugali. Kur i ka lindur vajza, ai ka qenë në Gjermani. Rroga në Portugali ishte e ulët. Tani më djali i tij është 29 vjeçar dhe me profesion është inxhinier i elektronikës, vajza (20 vjeçare) në fund të arsimimit në fizioterapi. «Falë punës në Zvicër, kam mundur tua siguroj fëmijëve të mi studimet. Ata janë më të rëndësishmit në jetë, pa ata e gjithë kjo nuk do të kishte kuptim. Mirëpo ka qenë tejet e vështirë edhe për fëmijët dhe për gruan time. Ne telefonojmë për çdo ditë dhe jemi

bashkë gjatë pushimeve. Mirëpo asgjë nuk mund të kompensojë kohën të cilën nuk kemi pasur mundësi ta kalojmë së bashku.»

Të zëmë kohën e humbur

Costa vjen nga një familje e varfër, ai është njëri nga 11 fëmijët. Si fëmijë shkente këmbëzbathur në shkollë. Tani ai ia ka arritur. «Unë nuk kam asgjë, mirëpo në krahasim me fëmijërinë time ndihem si një njeri i pasur.» Pas pak vitesh Costa do të përfitojë nga pensionimi i mëhershëm në ndërtimtarinë. «Unë dua që me gruan time të bëjë një udhëtim nëpër botë. Koha e humbur nuk rikthehet, megjithatë dua të zë kohën e humbur.»

Leja e përhershme e qëndrimit C

Leja e përhershme e qëndrimit C rregullohet përmes Ligjit për të huajt dhe për integrim dhe garanton të drejtën e qëndrimit të pakufishëm dhe të përhershëm në Zvicër. Në bazë të marrëveshjeve për qëndrim të përhershëm, personat nga Belgjika, Gjermania, Danimarka, Franca, Greqia, Italia, Lichtenstajni, Holanda, Austria, Portugalia, dhe Spanja kanë të drejtë që pas 5 vitesh të pandërprera qëndrimi të marrin lejen C. Drejtohuni për këtë çështje në entin kantonal të migracionit dhe shtroni një kërkesë të qartë. Për të realizuar këtë të drejtë nuk duhet të kenë borxhe dhe nuk duhet të jeni të dënuar penalisht si dhe të mos jeni të varur nga asistencë sociale.

Mattia Lento

Editorial



Rasti i një portugezi, të cilit iu deshtë të luftonte për lejen e përhershme të qëndrimit C dhe më në fund fitoi të drejtën nga këshilli i qytetit dhe sekretariati shtetëror për migracion (shih shkëmbimin për krahasim), si dhe vendimi nga Gjenerali, që të njihet «Uber» si punëdhënësi (faqe 2), tregojnë se ia vlen lufta për të drejtë të punëtoreve. Nëse porositen ushqimet apo të mirat konsumuese përmes një aplikacioni dhe dërgohen në shtëpi, atëherë përdoren teknologjitë moderne. Mirëpo edhe në këtë rast fjala është për fuqinë punëtore të njeriut. Janë njerëzit ata që kryejnë shërbime taksie, punë pastrimi apo transportimi, shpesh fjala është për migrant/e. Korporatat si Uber kështu fitojnë para, duke punësuar njerëz me kushte të këqija, pagë të keqe dhe marrëdhënie të pasigurta. Ky model shoqëror përçarë shoqërinë dhe krijon një shtresë të pasigurte shërbyese.

Suva, gjykatat dhe autoritetet shpesh kanë ardhur në përfundim, se tek rasti i Uber dhe platformave tjera, fjala është për punëmarrës. Ata duhet të jenë të siguruar karshi aksidentit por të jenë të siguruar edhe në aspektin e sigurisë sociale. Ata kanë të drejtë edhe në pushime dhe kompensim të ditëve festive, ndërsa platformat duhet të paguajnë kontribute e sigurimeve shoqërore.

Vlerësohet se Uber deri më tani ka mashtruar shoferët/et e saj me një shumë në qindra miliona. Platformat e tilla dëmtojnë ndërmarrjet korrekte përmes përparësisë të konkurrencës së paligjshme.

Platformat janë ndërmarrje sikur edhe tjerat dhe duhet të respektojnë ligjin e punës dhe ligjin e sigurimeve sociale. Teknologjitë e shekullit të 21-të ndërsa kushtet e punës sikur në shekullin e 19-të nuk shkojnë bashkë. Gjithashtu është me rëndësi që punëdhënësit të kenë qëndrim të sigurt.

Unia angazhohet për të drejtat e punëmarrësve. Vendimet pozitive në rastet e tanishme na fuqizojnë në punën tonë.

Beat Baumann,
ekonomisti i Unia-s

News

Ekspozita: Solidariteti i Comensoli-it me sindikatat

Nga 19 shtatori 2019 deri më 22 shkurt 2020 në Cyrih do të qëndroj hapur ekspozita mbi marrëdhëniet e piktorit Tesines, Mario Comensoli me sindikatat e Zvicrës. Comensoli ishte një piktor me sy për realitetin shoqëror, i cili e rrethonte. Punëtorët dhe punëtorët janë personazhet e dashura të pikturave të tija. Posaçërisht pasqyrimi i punëtorëve/eve migrant/e – figura madhështore me plot njerëzi dhe të krijuar me ngjyrë të kaltër – karakterizojnë veprat e tija më të njohura. Ekspozita në Cyrih tregon tipare të reja të veprave të Comensoli-t: Titujt e gazetave, afishet dhe pllakatet sindikaliste. Ai krijonte, fjala bie, pllakatën e kongresit të bashkimit mes sindikatës së ndërtimit dhe drurit (GBH) dhe asaj të tekstit kimisë dhe letrës (GTCP) të 5 shtatorit 1992, datë kjo që si rrjedhojë kishte themelimin e sindikatës së ndërtimit dhe industrisë (GBI). Kjo më pas i integrua në sindikatën e krijuar Unia.

Një film nga Ken Loach

Vendimi i Gjenevës në raport me «Uber» (shih shkrimin bashkëgjithorë në këtë faqe) është marrë në një periudhë, kur në shumë kinema të Zvicrës është duke u shfaqur filmi i ri i Ken Loach «Sorry We Missed You». Filmi tregon një histori të Ricky, i cili e nga viti 2008 bashkë me të shoqen Abby gjinden në një situatë të vështirë ekonomike. Dikur ai gjendet para mundësisë së paku në letër të jetë i pavarur dhe që për një ndërmarrje të realizojë dërgesa nëpër shtëpi. Puna është me vështirë se sa është prituri dhe pavarësia e dëshiruar vetëm një mjet për të bartur rrezikun e ndërmarrjes me tej tek punëmarrësi. Ricky më në fund e kupton, që bota e platformave të parregullta janë vetëm një mjet për të rritur fitimin në kurriz të punës.



Skandal i ri dumpingu në paga në Zvicrën lindore

Spekulanti i njohur i Zvicrës lindore Daniel Bächtold ia arriti rishtas që përmes një rrjeti kompanish të dyshimta të mos respektojë të drejtat e punëmarrësve. Kjo tregon edhe një herë më shumë: Nevojitet më shumë mbrojtje dhe kontrolle të të drejtave të punëtorëve. Tek Unia e St. Gallenit në muajt e fundit janë lajmëruar numër i madh i ish punëtorëve të SRI Baumanagement AG: Paleta e akuzave nisur nga shkarkimet e menjëhershme, mos pagesa e rrogave mujore, dumpingut në pagë, nxitja për sjellje ilegale, deri tek gënjeshttrat dhe premtimet e rrejshme.

Feldschlösschen i rrit përsëri pagat

Unia dhe komisioni i prodhimit me Feldschlösschen janë pajtuar në kuadër të bisedimeve vjetore për pagat: Në fillim të vitit 2020 shuma e pagave tek Feldschlösschen rritet për 0.75%. Rritja e pagës nominale bëhet individualisht. Paga minimale rritet për 100 franga. Pushimi i lehonisë nga viti i 3-të i shërbimit do të rritet për dy javë. Për arkën e pensioneve kontributet kursyese që nga 1 janari 2010 do të rriten për 10% dhe do të barten nga ndërmarrja.

Sistemi informativ i aleancës së ndërtimitarisë (ISAB/SAIC) Zgjerim i suksesshëm i sistemit të kontrollit në ndërtimtari

Gjashtë muaj pas startit të sistemit informativ të aleancës së ndërtimitarisë (ISAB/SAIC) mbi 10 000 firma që i nënshtrohen KKP-së mund të përdorin sistemin e kontrollit të ndërtimitarisë. Në fund të gushtit 2019 ISAB/SAIC iu bashkëngjiti sektori i punës (KKP) përgjithësisht detyrues në gjithë degën e ndërtimitarisë. Me bashkëngjitjen e sektorit të punës mund ti përdorin modulet e ISAB/SAIC-së. Tërësisht në ISAB/SAIC janë të përfshira të dhënat e mbi 10'000 ndërmarrjeve që i nënshtrohen KKP-së. Rreth 150 komisione tjera të paritetit të degës së ndërtimitarisë në Zvicër në javët dhe muajt e ardhshëm do të dorëzojnë njëra pas tjetres informacionet e tre kontrolluese.

Osman Osmani

Sistemi informativ i aleancës së ndërtimitarisë (ISAB/SAIC) përmirëson dhe modernizon zbatimin e Kontratës kolektive të punës (KKP) përgjithësisht detyrues në gjithë degën e ndërtimitarisë. Me bashkëngjitjen e sektorit të punës mund ti përdorin modulet e ISAB/SAIC-së. Tërësisht në ISAB/SAIC janë të përfshira të dhënat e mbi 10'000 ndërmarrjeve që i nënshtrohen KKP-së. Rreth 150 komisione tjera të paritetit të degës së ndërtimitarisë në Zvicër në javët dhe muajt e ardhshëm do të dorëzojnë njëra pas tjetres informacionet e tre kontrolluese.



ISAB/SAIC përmirëson dhe modernizon zbatimin e Kontratës kolektive të punës

Karta e ISAB/SAIC-së thjeshtëzon kontrollet e kantierëve

Që nga starti i ISAB/SAIC ne mars 2019 nga firmat janë porositur mbi 2500 karta të ISAB/SAIC-së për punonjësit e tyre. Kjo tregon se leja personale identifikuese e kantieret është pranuar pozitivisht para së gjithash edhe nga punëmarrësit. Kjo kartë thjeshtëzon kontrollet nëpër kantiere. Kodi QR i shtypur lejon inspektorin që të evidentojë se cilës ndërmarrje i përket punëto-

ri i ndërtimitarisë dhe njëherazi mund të shoh konformitetin e ndërmarrjes në fjalë.

Mund të kontrollohet edhe lidhja në arkën e kompensimit të AHV/AVS-it

Që ndërmarrja e cila i nënshtrohet KKP-së, të mund të porosis kartën ISAB/SAIC, duhet ti plotësojë disa parakushte: Kështu nuk duhet të ketë shkelje me kërkesa të hapura nga ndon-

jë kontroll i mëhershëm. Pos kësaj është detyrues që komisioni përgjegjës i paritetit e një dega apo regjioni në mënyrë eksplicite të lejojë dhënien e kartelave identifikuese për firmën në fjalë: për të mbështetur luftimin e punës në të zezë, partnerët social pos tjerash kanë vendosur, që kartat e ISAB/SAIC nga 1.1.2020 së pari kontrollon se ai iu janë bashkëngjitur firmat gjegjëse arkës të kompensimit AHV/(AVS para se atyre tua japi kartat e ISAB/SAIC.

Unia triumfon: Uber vepron ilegalisht! Gjigandi amerikan në Gjenevë duhet të paguajë përfitimet sociale

Pas vitesh të presioni sindikalist kantoni i Gjenevës ka vendosur që të ndalojë Uber, deri sa firma tu paguajë punonjësve të vet përfitimet sociale që atyre u takojnë. Kjo për Unia paraqet fitore. Mirëpo nuk mjafton: Edhe kantonet tjera duhet të veprojnë, për të mbrojtur punëmarrësit.

Mattia Lento, area Nr.17, 8 nëntor 2019 (e adaptuar)

Unia është gjatë kohë duke ushtruar presion, për të klasifikuar Uber-in si punëdhënës dhe me këtë të merre seriozisht përgjegjësinë karshi të punësuarve. Tani më kantoni i Gjenevës ka marrë parasysh kërkesat e sindikatave.

Rivendosja e ligjshmërisë

Umberto Bandiera, sekretar sindikal i Unia në Gjenevë, ka vite që punon në kuadër të digjitalizimit të tregut të punës. Është shumë i kënaqur, në të njëjtën kohë dëshiron të potencojë se «Vendimi i kantonit nuk është i jashtëzakonshëm, porse shkon në drejtim të rivendosjes së ligjshmërisë. Ka vite që

veprojnë ndërmarrjet si Uber deh autoritetet nuk i japin fund abuzimit dhe arbitrarizmit.»

Loja me kartën e shantazhit

Në rastin e Gjenevës, Uber do të apelojë vendimin, andaj do të veprojë deri në gjykimin vendimtar të gjyqit kantonial. Në ndërkohë gjigandi amerikan po përpiqet përmes mbështetjes së Partisë Liberale (FDP/PLR) të ushtrojë presion, duke kërcënuar se do të lëshojë Zvicrën: «Uber donë të na bindë se gjoja punonjësit e mbështesin atë, në të vërtetë po luan me kartën e shantazhit.» Për Bandiera «ne gjendemi para një kthesë radikale të teknologjisë së diktatit ekonomik.» Inovacioni është elementar, mirëpo kjo nuk duhet të jetë në atë

masë që gjigandët të diktojnë rregullat. Besueshmëria e shtetit, të kohezionit shoqëror dhe themelet e demokracisë sonë janë vënë në lojë.

Gjeneva udhëheq me shembullin e mirë

Deri më tani kantonet refuzonin që të obligonin Uber-in. Kjo kishte për pasojë që Uber përmes punës faktike në të zezë punëmarrësve ua ka hequr nga gjepi me miliona kontribute. Tani më Gjeneva ka dhënë një shembull të mirë dhe vendos Uber-in nën Ligjin e punës. Unia kërkon që edhe kantonet tjera të ndjekin këtë shembull dhe të obligojnë Uber-in që vozitësit/et e ti punësojë me rregull si dhe të paguajë kontributet për përfitime shoqërore.



Pamje nga protesta e punëmarrësve kundër dumpingut në page tek «Uber»

Zgjedhjet parlamentare në Zvicër Parlamenti i ri: i gjelbër, femëror – dhe më i majtë

Zgjedhjet nacionale për marrëdhëniet zvicerane kanë qar tek ndërrimet tektonike. Një analizë nga këndvështrimi sindikalist.

Clemens Studer Work, (adaptuar dhe plotësuar nga Marek Wieruszewski)

Parlamenti i ri nacional është më i ri, femëror, i gjelbër dhe më i majtë. Përqindja e grave është rritur prej 32% në 42%. Të Gjelbrit kanë fituar 17 ulëse, gjë në kuptimin e vërtetë është historik, PS humbë 4 ulëse. Mirëpo, para së gjithash SVP/UDC dhe FDP/PLR bashkë humbin 16 ulëse dhe kështu edhe shumicën në parlamentin nacional.

E djathta është humbësja

Para katër vitesh të djathtët dhe përtej të djathtëve ishin triumfuesit e mëdhenj. SVP/UDC dhe FDP/PLR në parlamentin nacional kishin shumicën absolute. Ata dominonin punën parlamentare. Të majtët u mbetën në shumicën e rasteve vetëm të provonin që të mënjanonin më të keqen. Tani kjo bile sa i përket ambientit dhe politikave shoqërore i takon të së kaluarës.

E majta është më e fuqishme edhe përkundër mos zgjedhjes së hidhur politike dhe personale të shefit të industrisë në Unia, Corrado Pardini, shanset për një politikë në kuptimin e të varurve nga paga janë shumë më të mira, se sa në katër vitet e kaluara. Pasi



Katër të gjelbër me shumë dhe dyfish më shumë gra në përbërjen e re të parlamentit

për politikën reale në pallatin federal nuk janë përcaktuese vetëm madhësitë e grupeve të caktuara parlamentare, por si përbëhen ato. Dhe këtu tregohet se nga këndvështrimi sindikalist fitimi i shumë ulëseve nga të gjelbërit qojnë më shumë peshë se sa humbjet e pakta të PS-së.

Senati dukshëm e qartë më shumë femëror

Edhe këshilli shtetëror i kantoneve (se-

nati) bëhet mi gjelbër dhe më femëror. Pati mjaftë befasi. Kështu parlamentarja aktuale nacionale Marina Carobbio e PS-së nga Kantoni Tesin u zgjodh si e para në senat. Senatoret e para vijnë dhe nga Kantoni Fribourg, Valis, Uri dhe Kantonin e Bazel-Land. Katër të gjelbër me shumë dhe dyfish më shumë gra se në legjislaturën e kaluar do të jenë të përfaqësuara – edhe fala grevës së grave, e cila është angazhuar fuqishëm për zgjedhjen e grave.

Projekti sindikalist arsimor «Intergesso: Fit për punë» Arsimim për migrantet në hoteleri

A jeni duke punuar në industrinë e mikpritjes në kantonin e Bernës dhe dëshironi të ecni përpara në jetë dhe në vendin e punës?

Osman Osmani

Projekti arsimor Intergesso u ofron punëmarrësve me gjuhë të huaj amtare një përcaktim të pozicionimit profesional dhe përmirëson qasjen për arsimim e trajnim të mëtejshëm profesional, për të rritur kështu shanset në tregun e punës.

Në programin arsimor janë paraparë:

- një përcaktim të pozicionimit profesional. Me këtë rast do të përfshihen dhe evidentohen hollësisht të gjitha përvojat dhe aftësitë e deritashme të pjesëmarrësve nga të gjitha fushat jetësore dhe do të përpilohet një plan aksioni, gjegjësisht arsimimi (rreth 15 leksione)
- Orientim dhe këshillim profesional nga këshilltar/e profesional/e të karrierës profesionale (20 leksione)
- Zënia e aftësive themelore në fushat vijuese (sipas nevojën):
- Lexim, Shkrim dhe aftësia e të shprehurit me gojë
- Njohuri themelore të matematikës
- Aplikim të teknologjive informative e komunikuese
- (Coach) Stërvitje individuale dhe e vazhdueshme (10 orë)

Fillimi i kursit dhe kostoja

Kurset fillojnë në vazhdimësi nëse ka lajmërim të mjaftueshme

Pjesëmarrëset paguajnë për tërë kursin arsimor CHF 250.-

Anëtarët e Unia paguajnë vetëm CHF 100.-

Të interesuar? Atëherë drejtohu tek:

ECAP Bern, Jadranka Soldo,
Tel. 031 381 81 33, jsoldo@ecap.ch

Unia Bern, Muriel Zürcher,
Tel 031 385 22 22, bern@unia.ch

www.intergesso.ch



Pamje nga pjesëmarrja në kurset arsimore të «Intergesso»

Intervista



«Women want more» (Gratë duan më shumë), ky është titulli i fushatës së re të Unia-s. Horizonte mbi këtë foli me Virginie Pilault, zëdhënëse e Unia.

Virginie, pse një fushatë me këtë titull «Women want more»?

Gratë me 14 qershor kanë thënë qartë: Ato duan respekt, kohë, para! «Women want more» është vazhdim logjik: Ne duam më shumë! Më shumë kohë, më shumë para dhe respekt! Edhe pse ligji për barazi gjinore është i ankoruar në kushtetutë që nga viti 1981 dhe gjysmë milioni njerëz dolën verës në rrugë, për të kërkuar barazi, gratë edhe më tej fitojnë 20% më pak se sa burrat. Ato edhe më tej kryejnë shumicën e punëve të shtëpisë, andaj edhe nuk kanë kohë që në punën e tyre të arsimohen e trajnohen dhe të zhvillohen më tej. Pos kësaj edhe më tej janë viktimat të seksizmit dhe formave të ndryshme të diskriminimit në vendin e punës.

A janë të përfshirë edhe migrantet/ët në këtë fushatë?

Qartë. Migrantet janë të prekura më së shumti nga pagat e ulëta dhe atë në dy kuptime. Në njërin anë diskriminohen individualisht. Në anën tjetër punojnë kryesisht në sektorët e dominuar nga gratë, ku pagat në mënyrë strukturore janë më të ulëta! Andaj është e domosdoshme të luftohet për respektimin e të drejtave të migraenteve, sikur për të gjitha punëtoret.

Cilat janë propozimet e Unia-s kundër diskriminimit të grave në botën e punës?

Faktikisht gratë janë edhe më tej viktimat të diskriminimit në botën e punës. Kjo mund të shprehet tek pagat, qasjes në arsimim, mirëpo edhe në ngacmimet, sjelljeve seksiste dhe të gjitha llojet e abuzimeve.

Nga ky sfond Unia ndër të tjera propozon: Tolerancë zero kundrejt seksizmit dhe ngacmimeve, 8 javë pushim atësie, një rritje të dukshme të pagave të ulëta në të ashtuquajturat degë të grave (përkujdesje, shitje pastrim, industri e orëve, gastronomi e hoteleri, floktari), pensione të arsyeshme të AHV/AVS për të mbuluar nevojat themelore, pa rritur moshën e pensionimit, orare më të shkurtra pune, dhënie fund punës me porosi afatshkurtër, pushime të mjaftueshme vjetore për të mbështetur familjarët si dhe përkujdesje dhe çerdhe të fëmijëve të financuara publikisht.

Përse zhvillohet tani fushata «Women want more»?

Duke pasur parasysh dallimin 20% të pagave, gratë që nga 21 tetori punojnë falas. Në këtë ditë ne ë kuadër të fushatës «Women want more» në Zvicër ne në shumë stacione kemi ndërtuar një «mur social». Kalimtarët janë ftuar që aty të lejnë mesazhe. Shumë njerëz kanë shprehur mllefën e tyre për këtë padrejtësi. Për këtë arsye ne kemi startuar me këtë fushatë në vjeshtën e këtij viti. Është edhe një mundësi që të ndiqet më tej greva e grave. Ne mbetemi të mobilizuar. Lufta për të drejta të grave vazhdon më tej!

A ka Unia kërkesa të menjëhershme konkrete?

Gjatë bisedimeve për paga në vjeshtë të këtij viti Unia kërkon për secilën grua së paku 50 franga më shumë, duke pasur një rritje pagash prej 2% për të gjithë. Në ndërmarrje, të cilat paguajnë paga ve4anërisht të ulëta, ne kërkojmë më shumë. Pos kësaj ne kërkojmë kontrolle sistematike të pagave në të gjitha ndërmarrjet dhe masa ndikuese për të mënjonuar diskriminimin në paga.

Si mund të mbështes unë fushatën?

Fushata zhvillohet para së gjithash në internet dhe në rrjetet sociale. Ti mund ti shohësh videot e fushatës dhe ti shpërndash në rrjetet sociale. www.unia.ch/fr/campagnes/women-want-more

Është shumë me rëndësi, të përhapet skandali mbi pabarazinë, të merret pjesë nëpër aksione dhe të motivohen edhe koleget për pjesëmarrje. Kështu ne mund të luftojmë bashkërisht diskriminimin dhe të mbrohemi më mirë, kur shfaqet ndonjë problem.

Marília Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Mbikëqyrja: Kamerat në dhomën e pauzave?

Unë punoj në një shitore në pikë karburantesh si shitëse. Para pak kohësh një kolege në besim më ka thënë, se pompa e gazit, lokali shitës si deh edhe dhoma jonë e qëndrimit dhe pushimit, mbikëqyren nga videot. Shefi ynë mund të shoh në çdo kohë, se çka ndodh aty. Që nga atëherë ndihem jo mirë. Posaçërisht kur moti është i keq dhe unë gjatë pauzave duhet të përdori dhomën e qëndrimit. A guxon të bëjë këtë shefi im?

REGULA DICK: Jo. Në një pikë karburantesh dhe edhe në një lokal shitjeje, mundet që për shkaqe sigurie apo për mbrojtje nga vjedhjet e nevojshme, që të mbikëqyren hapësira të caktuara. Mirëpo, mbikëqyrja e përkrahur gjerësisht nga ju nuk është proporcionale. Posaçërisht mbikëqyrja e dhomave të qëndrimit. Pos kësaj shefi juaj është dashur që të ju informojë mbi masat e mbikëqyrjes. Kërkonte nga shefi juaj që të kufizojë mbikëqyrjen në nevojat absolute vetëm sa i përket mbrojtjes nga vjedhja dhe për arsye sigurie.

Work, 1 nëntor 2019

Intervistë punësimi: A guxojë të gënjejë përkritazi me planifikimin familjar?

Unë (25 vjeçe) para pak kohësh kam aplikuar për një vend pune si kuzhinierë në një Hotel. Biseda ka shkuar shumë mirë. Pak para përfundimit të bisedës eprorja ime e ardhshme më ka pyetur se si qëndron puna përkritazi me planifikimin tim familjar. Pararendësja ime pas një viti pune ka mbetur shtatzënë. Unë u gjenda në një situatë mjaft të pakëndshme dhe nuk dija si të përgjigjem. Para disa muajsh jam martuar dhe natyrisht se ne dëshirojmë fëmijë. Mirëpo unë edhe pas pushimit të lehonisë dua të punoj më tej. Për mua ishte e qartë, se unë nuk do të punësohesha sikur të tregoja këtë. Andaj edhe jam përgjigjur se unë dhe burri im ende nuk duam fëmijë. A rrezikojë shkarkimin, nëse unë pas disa muajsh mbetem shtatzënë?

REGULA DICK: Jo. Pyetja për planifikimin familjar nuk ka të bëjë me aftësitë tuaja profesionale. Andaj kjo pyetje është e palejueshme, andaj edhe keni guxuar të gënjeni. Nëse shefja juaj për ketë arsye ju shkarkon, atëherë shkarkimi është abuziv, dhe ju keni të drejtë për një kompensim.

Work, 1 nëntor 2019

Përkujdesja: Pas një shërbimi gatishmërie natën të punosh menjëherë më tej?

Unë punoj si specialist i kujdesit në një shtëpi private pleqsh dhe përkujdesjeje.

Kur ne kemi shërbyer në kohën tonë të rregullt të punës si kujdestar natën, deri më tani në ditën e ardhshme e kishim të lirë: ne jemi të detyruar që gjatë kujdestarisë të qëndrojmë në shtëpinë e përkujdesjes së pleqve, pasi ne shpesh natën duhet të intervenojmë. Tani rishtas ne punojmë nga ora 13 deri 23, dhe pastaj kemi kujdestari natën deri në ora 7 të mëngjesit dhe menjëherë pas përfundimit të shërbimit të kujdestarisë na duhet të punojmë më tej deri në ora 13. A lejohet kjo?

IGOR ZORIC: Jo. Ju parimisht mundeni që krahas kohës normale të punës të shërbeni si kujdestar operativ, që mund të përdoret në të ashtuquajturin shërbim gatishmërie. Dhe kjo atëherë, kur duhet në jeni në gatishmëri për detyra të mundshme pune, për të evituar pengesat apo ndihmën në stacionin e emergjencës. Por se atëherë shërbimi i kujdestarisë në gjithë kohën e tij duhet të llogaritet si kohë pune. Kjo vlen edhe atëherë, kur gjatë shërbimit të kujdestarisë nuk duhet të intervenoni. Pas kësaj gatishmërie keni të drejtë në 11 orë pushim, para se të punoni përsëri.

Work, 15 nëntor 2019



Shërbimi i kujdestarisë duhet të llogaritet si kohë pune.

Fuqizohet Lëvizja punëtore në Shqipëri Minatorët e Bulqizës themelojnë një sindikatë të re

Një grup minatorësh nga Bulqiza kanë themeluar një sindikatë të re e cila premtan se do të rrisë nivelin e përfaqësimit të punëtorëve në industrinë minerare, një nga sektorët më vdekjeprurës të ekonomisë shqiptare.

Sami Curri, BIRN, Bulqizë, me 17 nëntor 2019

Dhjetëra minatorë dhe aktivistë për të drejtat e punëtorëve u mblodhën të dielën në qendër të Bulqizës për të njoftuar themelimin Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, një grupim i ri që premtan të përmirësojë përfaqësimin e punëtorëve në industrinë e kromit.

«Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës është ngritur prej vullnetit të vetë minatorëve që iu ka ardhur shpirti në majë të hundës prej padrejtësive,» tha Elton Debreshi, i cil është zgjedhur në krye të sindikatës për një mandat 3-vjeçar.

«Pikërisht sot nis puna dhe përpjekja reale për arritje për të mirën e minatorëve, të familjeve tona dhe të gjithë qytetit,» shtoi ai, duke nënvizuar se ky organizim i ri synonte «paga më të larta, kushte më të mira pune, njohjen e vështirësisë në punë, vjetërsisë në punë, të shumëpremtuarin statusin e minatorit dhe trajtimin dinjitoz të punës dhe sakrificës së minatorit.»



TAKIM NË SHESHIN QENDROR
TË QYTETIT, DITËN E DIELË
MË 17.11.2019 - ORA 11:00

Kromi është minerali më i rëndësishëm i Shqipërisë nga pikëpamja ekonomike. Aktualisht ka rreth 110 kompani të licencuara për të shfrytëzuar rezervat e kromit në zonën e Bulqizës, eksportet e së cilit arrijnë në rreth 100 milionë euro në vit.

Gjatë dekadës së fundit, rreth 300 minatorë kanë humbur jetën në të gjithë vendin si pasojë e aksidenteve në miniera. Por pavarësisht bilancit tragjik të viktimave, asnjë drejtues kompanie nuk është ndjekur penalisht gjatë viteve të fundit.

Sindikata u njoh ligjërisht më 15 tetor 2019 nga Gjykata e Tiranës dhe aktualisht kanë nisur anëtarësimet. Këshilli Sindikal do të jetë i përbërë nga 20 anëtarë dhe do të zbatojë vendimet e Asamblesë. Ndërsa kryetari do të jetë përfaqësues i Sindikatës dhe i vendimeve të marra nga shumica e anëtarëve.

«Kjo sindikatë është e re, jo për nga koha që është themeluar, por sepse ajo është ngritur dhe drejtohet nga punëtorët e minierës së Bulqizës – nga ata që punojnë në një punë të vështirë dhe të rrezikshme,» tha avokatja Holta Ymeri, e cili ka ndihmuar në regjistrimin e sindikatës.

«Kjo sindikatë është një mjet shumë i rëndësishëm në duart e minatorëve të Bulqizës, që të bashkuar të mund të kërkojnë kushte më të mira pune për të gjithë,» shtoi ajo.

Ndihmë për ngritjen e kësaj sindikate është dhënë nga aktivistët e Organizatës Politike në Tiranë që kanë punuar për organizimin dhe ngritjen e strukturave.

Beqir Duriçi, njëri nga anëtarët dhe themeluesit e sindikatës shprehet se grupimi i minatorëve që kanë marrë këtë nisim janë përpjekur të ndërtojnë një sindikatë të drejtë dhe demokratike.

«E rëndësishme të thuhet sot para gjithë qytetarëve të Bulqizës është fakti që ne kemi rënë dakord me njëri-tjetrin që Sindikatën e Bashkuar të Minatorëve të Bulqizës nuk do e udhëheqë as Eltoni, as Beqiri e asnjë punëtor tjetër i vetëm, por një grup i madh minatorësh të thjeshtë, të cilët duhet të mblidhen e të votojnë për të marrë vendime,» tha ai.

«Ne jemi njerëzit më të thjeshtë të këtij vendi i dimë më së miri hallet tona e të njëri-tjetrit,» përfundoi ai.



Protesta e minatorëve në Bulqizë, pas shkarkimit të kreut të sindikatës

25 nëntor 2019

Dhjetëra minatorë dhe anëtarë të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës protestuan të hënë në mëngjes, para hyrjes së minierës së kromit në Bulqizë që administrohet nga kompania Albchrome. Protesta u organizua pas shkarkimit nga puna në këtë kompani të kreut të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, vetëm pesë ditë pas prezantimit publik të sindikatës.

Minatorët e quajten të turpshëm vendimin e kompanisë, ndërsa e akuzuan atë për presione ndaj themeluesve të tjerë të sindikatës. Përfaqësues të sindikatës të Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës i bënë thirrje kompanisë Albchrome, që të tërhiqet nga vendimi i shkarkimit, pasi në të kundërt protestat do të ishin pa afat.

Ndërkohë Roland Kurti nga Inspektorati Shtetërorë i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për qarkun Dibër, i tha BIRN se për rastin e shkarkimit nga puna të kreut të sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi, ka nisur inspektimi dhe verifikimi i nevojshëm. Inspektorati bëri një takim me drejtuesit e sindikatës dhe po ashtu mori dëshmi rreth asaj që kishte ndodhur.



Adaptoi O. Osmani

Kushtetuta e Shqipërisë u nje punëtorëve të drejtën të bashkohen në sindikata për të mbrojtur interesin e tyre. Po ashtu Kodi i Punës ka marrë parasysh mundësinë e presioneve dhe ia ndalon kompanisë që të ndër marrë masa represive ndaj sindikalistëve, përfshi shkarkimin, masat disiplinore, uljen në detyrë e të ngjashme.

Kromi është minerali më i rëndësishëm i Shqipërisë nga pikëpamja ekonomike. Aktualisht ka rreth 110 kompani të licencuara për të shfrytëzuar rezervat e kromit në zonën e Bulqizës, eksportet e së cilit arrijnë në rreth 100 milionë euro në vit.

Ndërkohë punonjësit në këtë industri mbeten ndër më të rrezikuarit. Dhjetëra prej tyre humbin jetën çdo vit ose plagosen në punë. Por pavarësisht bilancit tragjik të viktimave, asnjë drejtues kompanie nuk është ndjekur penalisht gjatë viteve të fundit.